

KËRKESË PËR PRIVATIZIMIN E BANESAVE DHE OBJEKTEVE TË KTHYERA NË FOND BANESASH

<u>Emri i Shërbimit</u>	Kërkesë për privatizimin e banesave dhe objekteve të kthyer në fond banesash
<u>Përshkrim i Shkurtër</u>	<p>Kërkesa për privatizimin e banesave dhe objekteve të kthyer në fond banesash duhet të dërgohet në rrugë postare (letër rekomande), brenda 1 viti nga momenti i hyrjes në fuqi të vendimit të mëposhtëm nr.614, Njesisë së Qeverisjes Vendore, në territorin administrative në të cilin ndodhet banesa.</p> <p>Procedura e privatizimit fillon mbi bazën e kërkesës së:</p> <p>a) subjektit të pajisur me autorizim nga organet kompetente ose, në rast vdekjeje, të trashëgimtarëve të tij; ose</p> <p>b) të çdo personi të autorizuar me prokurë nga subjekti i përcaktuar në shkronjën “a”, më sipër</p>
<u>Baza ligjore:</u>	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Ligji nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” ▪ Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 614, datë 7.7.2015 “Për përcaktimin e procedurave të privatizimit të banesave dhe objekteve të kthyer në fond banese, me vendime të organeve të qeverisjes vendore, në pronësi të njësive të qeverisjes vendore dhe të shtetit, ku janë sistemuar me strehim banorë të pajisur me autorizim nga organet kompetente’
<u>Përfituesi</u>	Qytetarët
<u>Zyra Përgjegjëse</u>	Zyra/Specialisti i Drejtorisë Juridike
<u>Afati</u>	30 ditë
<u>Tarifa</u>	Nuk ka tarifë
<u>Dokumente të nevojshëm</u>	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Kërkesë që duhet të përmbajë: <ul style="list-style-type: none"> ○ Të dhënat personale të subjektit kërkues; ○ Të dhënat në lidhje me banesën ose objektin e kthyer në fond banese, për të cilin kërkohet privatizimi; ○ Datën dhe nënshkrimin e kërkuesit; ▪ Dokumentacioni bashkëngjitur kërkesës është: <ul style="list-style-type: none"> ○ Autorizimi për strehim, i lëshuar nga organet kompetente; ○ Certifikatën e gjendjes familjare të tre muajve të fundit; ○ Dokumentin e identifikimit të kërkuesit.
<u>Dokumenti/at e prodhuar si rezultat i shërbimit (outputs)</u>	Kontrata e privatizimit
<u>Sporteli ku drejtohet qytetari për marrjen e shërbimit</u>	Sporteli në Bashki Sporteli në Njësinë Administrative